

Alltun Çela



KRYETAR I GJYKATËS SË RREHIT SARANDË


Deklaratat e analizuarat:

15 Deklarata të analizuarat

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2003 deri Periodik/Vjetor 2017)

Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklarimit deri në vitin 2017

Ndryshimi i Pasurisë ndër Vite




6.4 herë Rritja e Pasurisë Bruto

+ 1,267,388 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë


Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë


Likuiditete në Bankë




Likuiditete në Cash



Pasuritë e Paluajtshme



Pasuritë e Luajtshme



Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

Të ardhurat 2004-2017	Shuma në Lekë	Raporti në %
Paga dhe shpërblime nga funksioni	15,155,231	47.5%
Paga e familjarëve	9,631,305	30.2%
Mësimdhënia	24,575	0.1%
Të ardhura nga qeraja	3,215,000	10.1%
Të ardhura nga pemishte dhe ullishte	2,030,000	6.4%
Të ardhura të tjera	1,882,179	5.9%
Total	31,938,290	100%



Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 14 vite rezultoi:

2 Me Probleme
12 Pa probleme.

Subjekti rezulton me probleme mosjustifikimi të pasurisë në vitin 2004 dhe 2010, përkatësisht në shumat 180,000 lekë dhe 1,412,268 lekë. Diferenca negative e vitit 2004 rezulton pasi subjekti nuk ka deklaruar të ardhura nga funksioni për këtë vit.

Gjatë periudhës deklaruese janë marrë hua shumat 3,500,000 lekë në vitin 2013 dhe 2,000,000 lekë në vitin 2016. Detyrimi i pakthyer deri me 31.12.2017 është 1,240,000 lekë. Në vitin 2005 subjekti ka deklaruar se me Vendim nr.2 dt.28.08.1999 të Këshillit Bashkiak ka përfituar sipërfaqe shesh ndërtimi 400 m2 në Sarandë, marrë në dorëzim me datë 15.07.2005 për të cilën subjekti shprehet: "në proces pa e kryer blerjen". Mënyra e përfitimit të këtij trualli nuk është e qartë.

Në vitin 2004, subjekti ka deklaruar se ka ndërtuar një shtesë kati 65 m2 me leje ndërtimi. Në vitin 2015, ai deklaron se pronësinë për shtesën e ka fituar me një vendim të Gjykatës së Rrethit Sarandë të vitit 2013 përmes parashkrimit fitues.